

20211031635

L I G J PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË PRAKTIKËS

Neni 1

Në Ligjin e Praktikës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Veriut Maqedonisë së Veriut” numër 98/19), titulli i kapitullit “VIII. Edukimi, dispozitat për kundërvajtje dhe barazim” ndryshohet dhe bëhet: “VIII. Dispozitat e kundërvajtjes dhe barazimit”, ndërkaq nëntitulli para nenit 19, fshihet.

Neni 2

Neni 19 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i punës konstaton se punëdhënësi, përkatësisht personi përgjegjës te punëdhënësi ka kryer kundërvajtje sipas nenit 20 të këtij ligji, inspektori i punës është i obliguar për kundërvajtjen e kryer të përpilojë procesverbal dhe me aktvendim të shqiptojë vërejtje dhe përcakton afat në të cilin punëdhënësi përkatësisht personi përgjegjës te punëdhënësi është i obliguar t’i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë.

(2) Nëse pas kalimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori i punës konstaton që parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjeluar, me aktvendim shqipton urdher për mënjanim të parregullsive dhe Aktvendimi sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, miratohet menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditëve nga dita e përpilimit të procesverbalit në pajtim me ligjin.

(4) Kur gjatë mbikëqyrjes inspektuese nuk janë konstatuar parregullsi dhe shkelje tjera të ligjit apo ndonjë dispozite tjetër apo parregullsitë e konstatuara janë mënjeluar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori i punës e ndërpret procedurën me konstatim në procesverbal në pajtim me ligjin.

(5) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, inspektori i punës mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë, të shënuar në procesverbal në pajtim me ligjin.

(6) Në rastin sipas paragrafit (5) të këtij neni, inspektori i punës është i obliguar menjëherë, ndërkaq më së voni në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, të miratojë aktvendim me gojë për shqiptim të masës inspektuese.

(7) Kundër aktvendimit sipas paragrafëve (1), (2) dhe (6) të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktvendimit, në organin kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin.

(8) Ankesa sipas paragrafit (7) të këtij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit sipas paragrafëve (1), (2) dhe (6) të këtij neni.

(9) Për vërejtjet e shqiptuara, Inspektorati Shtetëror i Punës mban evidencë, në mënyrë të përcaktuar nga ministri kompetent për çështjet nga fusha e punës.“.

Neni 3

Neni 20 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjohë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël - person juridik, gjohë në shumë prej 500 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm - person juridik dhe gjohë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh - person juridik, nëse:

- lidh kontratë për punë praktike me praktikant i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat e këtij ligji (neni 3 të këtij ligji),

- siguron praktikant për nevojat e tij pa konkurs publik të shpallur në ueb faqen e tij dhe/ose në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut apo medie tjetër publike dhe konkursi nuk përmban informata për kushtet për punë praktike në pajtim me dispozitat nga ky ligj (neni 4 të këtij ligji),

- nënshkruan kontratë për punë praktike në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh apo lejon punë praktike më shumë herë me të njëjtin person (neni 6 të këtij ligji),

- angazhon numër më të madh të praktikantëve nga numri i përcaktuar me dispozitat nga ky ligj (neni 7 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji),

- nuk i siguron praktikantit të drejtë për kompensim mujor me para dhe nuk i paguan kompensim mujor me para praktikantit në shumë neto për orar të plotë pune për punë të kryer të praktikantit apo nuk paguan shumë proporcionale për punën e praktikantit për orar pune më të shkurtë nga orari i plotë (neni 8 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji),

- nuk i paguan praktikantit pjesë proporcionale, si kompensim për kryerje të punës së praktikantit, në rast të mungesës nga puna në çfarëdo baze përveç pushimit gjatë kohës së punës dhe festave të përcaktuara me ligj apo nuk e paguan kompensimin deri më datën 15 në muajin rrjedhës për muajin e kaluar (neni 8 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji),

- para lidhjes së kontratës për punë praktike praktikantit nuk i jep përkrahje me shkrim të qëllimeve, detyrave dhe procesit të praktikës, nuk e njofton me kushtet për punë dhe rreziqet në lidhje me punën gjatë praktikës apo nuk e njofton me aktet e përgjithshme të punëdhënësit (neni 9 paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij ligji),

- nuk i siguron praktikantit pushim ditor dhe javor në pajtim me dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës, nuk i siguron dhe nuk i paguan kompensim për punë praktike sipas nenit 8 të këtij ligji ose nuk i paguan kompensim të shpenzimeve për udhëtime zyrtare dhe kompensime tjera që kanë ndodhur për nevojat e kryerjes së punës praktike (neni 9 paragrafi (1) alinetë 4, 5, 6 dhe 7 të këtij ligji),

- nuk shpall konkurs publik për nevojën për praktikant në ueb faqen e tij apo në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut apo medie tjetër publike, nuk i përcakton qëllimet për angazhim, detyrat dhe procesin e punës së praktikantit (neni 11 paragrafi (1) nënparagrafi 1 dhe 2 të këtij ligji),

- nuk nënshkruan kontratë për punë të praktikantit me kandidatin e zgjedhur, nuk e lajmëron praktikantin dhe nuk e ç'lajmëron në afatet e përcaktuara me këtë ligj, nuk siguron person përgjegjës - mentor për monitorim të vazhdueshëm të praktikantit apo lejon punë të pavarur të praktikantit, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 11 paragrafi (1) nënparagrafët 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji),

- nuk i siguron praktikantit kushte optimale për punë dhe materiale si dhe mjete për punë, nuk i jep vërtetim për dituritë, shkathtësitë dhe kompetencat e fituara në afatin e përcaktuar dhe përkrahje të punës praktike si dhe kohëzgjatjen e saj, nuk i paguan rregullisht kompensim në pajtim me kontratën, nuk paguan tatim mbi të ardhurat personale për shumën e paguar të kompensimit në pajtim me ligjin, nuk siguron mjete për mbrojtje gjatë punës nëse është përcaktuar të aplikohen në vendin e punës në të cilin kryen punë praktikanti, nuk siguron fshehtësi të të dhënave personale dhe mbrojtje të privatësisë, nuk paguan kontribut në bazë të invaliditetit dhe dëmshpërblim trupor të shkaktuar me lëndim në punë apo sëmundje profesionale dhe kontribut plotësues për sigurim të detyrueshëm shëndetësor në rast të lëndimit në punë dhe sëmundjes profesionale (neni 11 paragrafi (1) nënparagrafët 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij ligji),

- i arkëton praktikantit shpenzime për punë trajnim, shpenzime për transport, për materiale pune dhe shpenzime tjera në lidhje me kryerjen e punës së praktikantit (neni 11 paragrafi (2) të këtij ligji),

- mundëson punë të praktikantit pa kontratë për punë praktikanti në formë të shkruar, nënshkruan kontratë për praktikë me person më të ri se 18 vite, pa qenë kontrata e nënshkruar nga praktikanti dhe prindi apo kujdestari, mundëson me kontratë për punë praktikanti të zëvendësohet vendi ekzistues i punës (neni 12 paragrafi (1), (2), (3) dhe (5) të këtij ligji),

- nënshkruan kontratë për punë praktike me përmbajtje në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 13 të këtij ligji),

- nuk e pranon deklaratën me shkrim për ndërprerje të kontratës për punë praktike, nuk e anulon kontratën për punë praktike në afatin e caktuar, e ndërpret kontratën për punë praktike në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 14 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji) dhe

- në mënyrë të parregullt mban ose nuk mban evidentë të orëve të punës së praktikantit (neni 15 të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 150 uro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni personit përgjegjës në personin juridik në punëdhënës mikro dhe të vogël, 300 euro në kundërvlerë me denarë në punëdhënës të mesëm dhe 400 euro në kundërvlerë me denarë në punëdhënës të madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni punëdhënësit - person fizik.”.

Neni 4

Neni 21 ndryshohet dhe bëhet:

“Gjobë në shumë prej 50 deri 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar, nëse nuk mban evidencë të orëve të punës së praktikantit, në pajtim me këtë ligj (neni 15 të këtij ligji).”.

Neni 5

Neni 22 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Për kundërvajtjet sipas nenit 20 të këtij ligji, inspektori i punës, para se të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje, është i obliguar personit përgjegjës apo personit të autorizuar prej tij në punëdhënës, t'i ofrojë procedurë për kompensim me lëshim të urdhërpagesës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin të Kundërvajtjes.

(2) Nëse kryerësi e paguan gjobën në afat prej tetë ditëve nga lëshimii të urdhërpagesës për kundërvajtje, do ta paguajë gjysmën e gjobës së paraparë, ndërkaq nëse nuk e paguan në afatin e paraparë, personi i autorizuar zyrtar do të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje në organin kompetent.

(3) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje i përcakton ministri kompetent për çështjet nga fusha e punës.”

Neni 6

Neni 23 fshihet.

Neni 7

Neni 24 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Për kundërvajtjet sipas nenit 20 të këtij ligji procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton komisioni për kundërvajtje, që është i formuar nga ministri kompetent për çështjet nga fusha e punës.

(2) Për kundërvajtjen sipas nenit 21 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

(3) Realizimi i të drejtës për mjet juridik kundër vendimit të komisionit për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni, si dhe procedura për mjet juridik kundër vendimit të gjykatës kompetente sipas paragrafit (2) të këtij neni zbatohet në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.”

Neni 8

Në gjithë tekstin e ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 9

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 10

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekstin e zbardhur të Ligjit të Praktikës.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.